



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR KANDIDATËT PËR TRAJNUES PËR ANGAZHIM
NË PROGRAMIN “PAS SHKOLLE” PËR VITIN SHKOLLOR 2026-2027**

Në zbatim të pikës 3, të nenit 47/1, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 627, datë 30.7.2026 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e organizimit dhe zhvillimit të programit “Pas shkolle” të kategorive, kritereve dhe mënyrës së përzgjedhjes, shpërblyerjes të trajnuesve, si dhe mënyrës së financimit të këtij programi” dhe të urdhrit nr. 400, datë 31.7.2026, “Për miratimin e llojeve të programit “Pas shkolle”, standardeve, kritereve, planit të veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar”, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar shpall thirrjen për aplikim për kandidatët për trajnues në programin “Pas shkolle” në arsimin parauniversitar publik.

Konteksti i përgjithshëm i programit “Pas shkolle” dhe angazhimi i trajnuesve

Programi “Pas shkolle” është një program i organizuar dhe i strukturuar në veprimtari që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar, me synim përfundimtar të nxënësve dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të nxënësve. Përmes një game të larmishme veprimtarish edukative, krijuese, kulturore, sportive dhe zhvilluese, programi synon të nxisë aftësitë, talentet, kreativitetin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të tyre.

Veprimtaritë e programit konceptohen si hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse, ku nxënësit angazhohen në mënyrë aktive, mësojnë përmes praktikës dhe ndërveprimit, zhvillojnë kreativitetin dhe aftësitë e tyre, si dhe ndërtojnë marrëdhënie pozitive me bashkëmoshatarët dhe komunitetin shkollor.

Përmes kësaj thirrjeje publike synohet të identifikohen dhe angazhohen trajnues të kualifikuar, profesionistë dhe të motivuar, të cilët zotërojnë njohuritë dhe përvojën e nevojshme në fushat përkatëse dhe kanë aftësi për të punuar me fëmijë dhe të rinj. Trajnuesit e përzgjedhur do të kontribuojnë në realizimin cilësor të programit dhe në arritjen e objektivave të tij edukative dhe zhvilluese.

Programi synon të shtrihet në mënyrë të strukturuar në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar, duke u konsoliduar si një model i qëndrueshëm i veprimtarive pas mësimi. Në këtë mënyrë, ai synon të kontribuojë jo vetëm në zhvillimin akademik, personal dhe social të nxënësve, por edhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit.

1. Objekti dhe qëllimi i thirrjes

Objekti i kësaj thirrjeje publike është përzgjedhja dhe angazhimi i trajnuesve për realizimin e veprimtarive në kuadër të programit “Pas shkolle”.

Qëllimi i thirrjes është të identifikojë profesionistë me njohuri, aftësi dhe përvojë në fushat përkatëse, të cilët do të angazhohen në planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive cilësore, praktike dhe ndërvepruese me nxënësit e angazhuar në program.

Angazhimi i trajnuesve synon të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues, që vendos në qendër nevojat, interesat dhe potencialin e secilit nxënës, për të zhvilluar njohuritë, aftësitë, kreativitetin, talentet dhe kompetencat e tyre personale e sociale.

2. Fushat e veprimtarive për të cilat kërkohen trajnues

Në kuadër të programit “Pas shkolle”, do të angazhohen trajnues për fushat e përcaktuara në vendimin nr. 627, datë 30.7.2026 të Këshillit të Ministrave dhe në Urdhrin nr. 400, datë 31.7.2026.

ndryshme, në përputhje me veprimtaritë e parashikuara të programit.

Në kuadër të programit, veprimtaritë do të zhvillohen në fushat e mëposhtme:

- ✓ **Bëjmë detyrat e shtëpisë** – mbështetje e nxënësve në realizimin e detyrave të shtëpisë, përforcimin e njohurive të fituara gjatë procesit mësimor dhe zhvillimin e shprehive të të nxënësit dhe punës së pavarur;
- ✓ **Muzikë** – zhvillimi i aftësive dhe interesit muzikor të nxënësve përmes veprimtarive praktike dhe krijuese;
- ✓ **Teatër** – zhvillimi i aftësive të komunikimit, të shprehjes dhe interpretimit, kreativitetit dhe bashkëpunimit përmes veprimtarive teatrore;
- ✓ **Kërcim** – zhvillimi i shprehjes artistike përmes lëvizjes, ritmit dhe veprimtarive të ndryshme të kërcimit;
- ✓ **Zeje** – zhvillimi i aftësive praktike dhe krijuese përmes punës me teknika dhe materiale të ndryshme;
- ✓ **Arte pamore** – zhvillimi i krijimtarisë dhe shprehjes artistike përmes vizatimit, pikturës dhe teknikave të tjera të artit pamor.

Për realizimin e këtyre veprimtarive, në kuadër të thirrjes publike do të përzgjidhen trajnues sipas fushave përkatëse, në përputhje me kualifikimet, përvojën dhe kriteret e përcaktuara për secilën fushë. Aplikantët mund të aplikojnë për një ose më shumë fusha, në varësi të kualifikimeve dhe përvojës së tyre.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trajnuesve

Trajnuesit e përzgjedhur do të jenë përgjegjës për:

- ✓ planifikimin dhe përgatitjen e veprimtarive në fushën përkatëse;
- ✓ hartimin/përshtatjen e përmbajtjes dhe materialeve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive;

- ✓ realizimin e lëndës dhe klubeve, sipas planit dhe kalendarit të miratuar të programit;
- ✓ përdorimin e metodave praktike, pjesëmarrëse dhe ndërvepruese;
- ✓ përshtatjen e metodologjisë dhe përmbajtjes sipas grupmoshës, nivelit dhe nevojave të nxënësve;
- ✓ krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të sigurt, pozitiv, gjithëpërfshirës dhe respektues;
- ✓ nxitjen e pjesëmarrjes aktive, bashkëpunimit dhe kreativitetit;
- ✓ përgatitjen e nxënësve për veprimtari dhe aktiviteteve të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin;
- ✓ bashkëpunimin me koordinatorët dhe stafin përgjegjës të programit;
- ✓ respektimin e rregullave, procedurave dhe standardeve të programit, veçanërisht atyre që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e nxënësve;
- ✓ përgatitjen e raporteve ose evidencave të kërkuara lidhur me realizimin e veprimtarive dhe progresin e tyre.

4. Kriteria të përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- ✓ të kenë arsimim, kualifikim profesional, certifikim ose ekspertizë të dëshmueshme në fushën për të cilën aplikojnë;
- ✓ të kenë njohuri dhe aftësi praktike në fushën përkatëse;
- ✓ të kenë aftësi të mira komunikimi, organizimi dhe bashkëpunimi;
- ✓ të jenë të aftë të punojnë në mënyrë të përgjegjshme me fëmijë dhe/ose të rinj;
- ✓ të demonstrojnë profesionalizëm, korrektësi dhe përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave;
- ✓ të jenë të gatshëm të respektojnë parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së nxënësve.

Përvojë e mëparshme në zhvillimin e trajnimeve, kurseve, klubeve, veprimtarive jashtëshkollore ose programeve edukative me fëmijë dhe të rinj do të konsiderohet avantazh.

5. Kohëzgjatja dhe kushtet e angazhimit

Trajnuesit do të angazhohen për periudhën **1 tetor 2026 – 18 qershor 2027**, sipas kalendarit të programit **“Pas shkolle”**.

Veprimtaritë do të zhvillohen në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar, ku do të zbatohet programi, sipas një orari të përcaktuar paraprakisht në bashkëpunim me titullarin e institucionit arsimor publik. Kushtet e kontraktimit dhe masa/mënyra e kompensimit financiar do të përcaktohen në përputhje me procedurat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Pagesa për çdo orë për zbatimin e programit **“Pas shkolle”** për trajnuesit, për veprimtaritë që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar, është 1 000 (një mijë) lekë. Shpërblimi për realizimin e programit **“Pas shkolle”**, për trajnuesit e punësuar në institucionet parauniversitare publike, nuk përbën pjesë të pagës mujore dhe nuk ndikon në ngarkesën mësimore të detyrueshme.

6. Dokumentacioni i kërkuar

I. Për veprimtaritë që lidhen me mbështetje dhe përforcimin e të nxënësve, të cilat synojnë konsolidimin e njohurive, aftësive, zhvillimin e kompetencave dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve, zhvillohen nga trajnuesit, si vijon:

- A. Aplikimi i kandidatit, mësues i punësuar në institucionet arsimore parauniversitare publike me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar apo me kohëzgjatje të caktuar bëhet në sistemin e menaxhimit të informacionit (SMIP). Dokumentacioni i dosjes për aplikimin e kandidatëve merren përmes ndërveprimit nga SMIP.

Pikëzimi i dosjeve dhe përzgjedhja e kandidatit të punësuar në institucionin arsimor parauniversitar publik përkatës bëhet nga një komision në nivel shkolle, me 3 (tre) anëtarë me përbërje si më poshtë:

- drejtori i shkollës;
- një mësues i zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
- kryetari i këshillit të prindërve të institucionit.

- B. Aplikimi i kandidatit, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe i është nënshtruar provimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, sipas akteve të posaçme që rregullojnë procedurën e konkurrimit në këtë portal dhe ndodhet në listë pritjeje për një vend të lirë pune në institucionet arsimore parauniversitare publike, për vitin shkollor 2026-2027, paraqet kërkesën për aplikim në rrugë elektronike në adresën e zyrës vendore arsimore parauniversitare, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor. Dokumentacioni i dosjes për aplikimin e kandidatëve merret përmes ndërveprimit nga portali “Mësues për Shqipërinë”.

Kandidati që ka konkurruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” përzgjidhet në përputhje me profilin e mësuesit të kërkuar nga institucioni arsimor, duke respektuar renditjen e tyre në portal sipas pikëve totale të fituara. Procedura për angazhimin e trajnuesit, kryhet nga Komisioni ad-hoc i ngritur nga ZVAP, i cili përbëhet nga drejtuesi i ZVAP-së dhe dy anëtarë.

- C. Aplikimi i individit, i cili ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë dhe ka ushtruar më parë mësimdhënie në institucionet arsimore publike;
- D. Aplikimi i individit, që është diplomuar në fushën e mësuesisë apo në fusha të përafërta në një program të ciklit të dytë të studimeve, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo institucione të huaja të arsimit të lartë, për të cilin është njohur dhe njësuar diploma e huaj bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që aplikojnë sipas përcaktimeve në pikën C dhe D , dorëzojnë dosjen e aplikimit në zyrën vendore të arsimit parauniversitar, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor, sipas dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) formulari i aplikimit; (shtojca nr. 4)
- b) jetëshkrim (CV);
- c) kopje të diplomës/ave të arsimit të lartë dhe listës së notave/suplement i diplomës;
- d) vërtetim mjeko-ligjor;
- e) certifikatë të gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti);
- f) vërtetim nga Prokuroria që kandidati nuk është në ndjekje penale për kryerjen e një vepre penale;
- g) vërtetim nga Gjykata që kandidati nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- h) kopje të certifikatave/dëshmime për trajnime të kryera (nëse ka).
- i) deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;
- j) vërtetim pensioni, për individin i cili ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë.

Pikëzimi i dosjeve për kandidatët bëhet nga një komision vlerësimi ad-hoc i ngritur nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, nga të cilët dy janë përfaqësues të zyrës vendore arsimore parauniversitare dhe një përfaqësues nga drejtoria rajonale arsimore parauniversitare.

II. Për veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e aftësive artistike, kulturore, krijuese dhe praktike të nxënësve, zhvillohet nga trajnuesit, si vijon:

- A. Aplikimi i kandidatit, mësuesi, i cili ushtron profesionin e mësuesit në profilet artistike, i punësuar në institucionet arsimore parauniversitare publike me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar apo me kohëzgjatje të caktuar, bëhet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (SMIP). Dokumentacioni i dosjes për aplikimin e kandidatëve merren përmes ndërveprimit nga SMIP.

Pikëzimi i dosjeve dhe përzgjedhja e kandidatit të punësuar në institucionin arsimor parauniversitar publik përkatës bëhet nga një komision në nivel shkolle, me 3 (tre) anëtarë me përbërje si më poshtë:

- drejtori i shkollës;
- një mësues i zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
- kryetari i këshillit të prindërve të institucionit.

- B. Aplikimi i kandidatit, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilet artistike dhe i është nënshtruar provimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, sipas akteve të posaçme që rregullojnë procedurën e konkurrimit në këtë portal

dhe ndodhet në listë pritjeje për një vend të lirë pune në institucionet arsimore parauniversitare publike, për vitin shkollor 2026-2027, paraqet kërkesën për aplikim në rrugë elektronike në adresën e zyrës vendore arsimore, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor. Dokumentacioni i dosjes për aplikimin e kandidatëve merren përmes ndërveprimit nga portali “Mësues për Shqipërinë”.

Kandidati që ka konkurruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” përzgjidhet në përputhje me profilin e mësuesit të kërkuar nga institucioni arsimor, duke respektuar renditjen e tyre në portal sipas pikëve totale të fituara. Procedura për angazhimin e trajnuesit, kryhet nga Komisioni ad-hoc i ngritur nga ZVAP, i cili përbëhet nga drejtuesi i ZVAP-së dhe dy anëtarë.

- C. Aplikimi i individit, i cili ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë dhe ka ushtruar më parë mësimdhënien në profilet artistike në institucionet arsimore publike ose ka ushtruar profesionin në këto profile në institucionet kulturore publike.
- D. Aplikimi i individit, i cili është diplomuar në fushën e mësuesisë apo në programe studimi të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar në profilet artistike, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo institucione të huaja të arsimit të lartë, për të cilin është njohur dhe njësuar diploma e huaj bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi;
- E. Aplikimi i individit i cili ka përfunduar një program studimi të ciklit të dytë në fushën e arteve;

Kandidatët që aplikojnë sipas përcaktimeve në pikën C, D dhe E dorëzojnë dosjen e aplikimit në zyrën vendore të arsimit parauniversitar, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor parauniversitar publik, sipas dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) formulari i aplikimit; (shtojca nr. 4)
- b) jetëshkrim (CV);
- c) kopje të diplomës/ave të arsimit të lartë dhe listës së notave/suplement i diplomës;
- d) vërtetim mjeko-ligjor;
- e) certifikatë të gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti);
- f) vërtetim nga Prokuroria që kandidati nuk është në ndjekje penale për kryerjen e një vepre penale;
- g) vërtetim nga Gjykata që kandidati nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- h) kopje të certifikatave/dëshmive të veprimtarive, projekteve në fushën e kërkuar;
- i) deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;
- j) vërtetim pensioni, për individin i cili ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë.

Pikëzimi i dosjeve për kandidatët bëhet nga një komision vlerësimi ad-hoc i ngritur nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, nga të cilët dy janë përfaqësues të zyrës vendore arsimore parauniversitare dhe një përfaqësues nga drejtoria rajonale arsimore parauniversitare.

- F. Aplikimi i artizanëve të mjeshtërive të ndryshme të dihebërjes dhe zejeve, të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit ose Regjistrin e Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale.

Kandidatët dorëzojnë dosjen e aplikimit në zyrën vendore të arsimit parauniversitar (në vijim ZVAP), nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor.

Dosja e aplikimit përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) formulari i aplikimit; (shtojca nr. 4)
- b) jetëshkrim (CV);
- c) vërtetimin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale që janë pjesë e Regjistrit Kombëtar të Bartësve të Folklorit ose Regjistrit të Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale.
- d) vërtetim mjeko-ligjor;
- e) certifikatë të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- f) vërtetim nga prokuroria që kandidati nuk është në ndjekje penale për kryerjen e një vepre penale;
- g) vërtetim nga Gjykata që kandidati nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- h) kopje të certifikatave/dëshmime të veprimtarive, projekteve në fushën e kërkuar;
- i) deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura.

Pikëzimi i dosjeve për kandidatët bëhet nga një komision vlerësimi ad-hoc i ngritur nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, nga të cilët dy janë përfaqësues të zyrës vendore arsimore parauniversitare dhe një përfaqësues nga drejtoria rajonale arsimore parauniversitare.

7. Mënyra dhe afati i aplikimit

1. **Mësuesi i punësuar në institucionet arsimore parauniversitare publike** aplikon nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).
2. **Kandidati që ka konkurruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe është në listën e pritjes për një vend të lirë pune** paraqet kërkesën për aplikim sipas shtojcës nr. 4 në rrugë

elektronike në adresën e zyrës vendore arsimore parauniversitare, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor.

3. **Kandidatët e kategorive të tjera** dorëzojnë dosjen e aplikimit pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor për të cilin aplikojnë.

Afati për aplikim është nga data **01.09.2026** deri në datën **10.09.2026**.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit ose aplikimet që nuk përmbajnë dokumentacionin e kërkuar nuk merren në shqyrtim.

1. Komisioni bën vlerësimin e dosjeve të aplikantëve nga data 11.09.2026-17.09.2026, 5 (pesë) ditë pune.
2. Rezultatet e vlerësimit paraprak publikohen në faqen zyrtare të AKAP, DRAP dhe të ZVAP.
3. Kandidatët bëjnë ankimimin për vlerësimin me pikë dhe verifikimin e dosjeve për kualifikim, nga data 18.09.2026 deri më 23.09.2026 3 (tri) ditë pune.
4. Komisioni shqyrton ankesat brenda 2 (dy) ditëve punë, nga data 24.09.2026-25.09.2026 dhe publikon rezultatet e vlerësimit përfundimtar në faqen zyrtare të AKAP, DRAP dhe të ZVAP.
5. Institucioni arsimor parauniversitar publik, në varësi të grup/klubeve të krijuara, njofton kandidatët e përzgjedhur për lidhjen e kontratës, ku trajnuesi angazhohet për programin “Pas shkolle”.

Institucioni arsimor vendor/institucioni arsimor zbatues ka të drejtën të verifikojë informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët përpara përfundimit të procesit të përzgjedhjes dhe/apo lidhjes së kontratës me institucionin arsimor.

Shtojcë nr. 1

Ndarja territoriale

I. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË

(Adresa: Rruga “Jeronim De Rada”, Tiranë)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Kamëz	Kamëz
Tiranë	Tiranë
Kavajë	Kavajë
Vorë	Vorë
Rrogozhinë	Rrogozhinë

II. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

(Adresa: Lagjja Nr. 3, Rruga “Egnatia” Kutia Postare 2001, Durrës)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Dibër	Dibër
Krujë	Krujë
Durrës	Durrës
Bulqizë	Bulqizë
Mat	Mat
Klos	Klos
Shijak	Shijak

III. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

(Adresa: Sheshi “Gjergj Kastrioti”, kati 2, godina QKF “Gjergj Lacaj”, Lezhë)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Has	Has
Tropojë	Tropojë
Mirditë	Mirditë
Malësi e Madhe	Malësi e Madhe

Vau Dejës	Vau Dejës
Pukë – Fushë Arrëz	Pukë Fushë Arrëz
Kukës	Kukës
Lezhë	Lezhë
Kurbin	Kurbin
Shkodër	Shkodër

IV. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
(Adresa: Lagjja 18, Rruga “Dhimitër Denasi” 7001, Korçë)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Dimal	Dimal
Kuçovë	Kuçovë
Cërrik	Cërrik
Belsh	Belsh
Peqin	Peqin
Gramsh	Gramsh
Librazhd	Librazhd
Përrenjas	Përrenjas
Maliq	Maliq
Kolonjë	Kolonjë
Berat	Berat
Korçë - Pustec	Korçë dhe Pustec
Devoll	Devoll
Pogradec	Pogradec
Elbasan	Elbasan

V. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

(Adresa: Lagjja “Kastriot”, Rruga “Leon Rei”, Fier)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Patos	Patos
Roskovec	Roskovec
Divjakë	Divjakë
Mallakastër	Mallakastër
Selenicë	Selenicë
Tepelenë - Memaliaj	Tepelenë dhe Memaliaj
Përmet - Këlcyrë	Përmet dhe Këlcyrë
Sarandë - Delvinë- Konispol	Sarandë, Konispol dhe Delvinë
Lushnjë	Lushnjë
Vlorë - Himarë	Vlorë dhe Himarë
Fier	Fier
Gjirokastrë - Libohovë	Gjirokastrë dhe Libohovë

Shtojcë nr. 2**Kriteret dhe skema e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve të kategorisë “mësues”.**

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi
1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I dhe nota mesatare e ciklit II) ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Për kandidatët që zotërojnë diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND) ose program të integruar studimi merret nota mesatare e programit përkatës. Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë; Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë; Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë; Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë; Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë; Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë; Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë; Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë; Nota mesatare 9.01 – 9.50 = 7 pikë; Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 10 pikë.	0.5–10 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1–2 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 1.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 2 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”); b) Mësues Specialist (kategoria II) 3–4 pikë (3 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”); c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 5 pikë Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me 0 (zero) pikë.	0–5 pikë
3	Trajnime: Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. i. 10 kredite =1 pikë; ii. 20 kredite =3 pikë; iii. 30 ose mbi 30 kredite = 5 pikë. Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.	0–5 pikë
4	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor. Kandidati që nuk ka përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.	0–10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)
	Totali	30 pikë

Shtojcë nr. 3**Kriteret dhe skema e vlerësimit të dosjeve të kategorive të tjera.**

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi
1	Nota mesatare e studimeve të larta (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e DIND ose e programit të integruar të studimit)/ të mesme, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore. Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë; Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë; Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë; Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë; Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë; Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë; Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë; Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë; Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë; Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë.	Vlerësimi me pikë (0.5-10)
3	Certifikata trajnimesh. Certifikata/dëshmi të veprimtarive, projekteve në fushën e kërkuar. i.1 certifikatë = 1 pikë; ii. 2 certifikata = 3 pikë; iii. 3 ose mbi 3 certifikata = 5 pikë.	Vlerësimi me pikë (0-5)
4	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe /ose përvoja në veprimtari artistike.	Vlerësimi me pikë 0-10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite pune)
5	Portofol i punimeve/krijimeve/workshop-eve/ekspozitave, etj., sipas fushave përkatëse. Kandidati që nuk zotëron portofol të punimeve, vlerësohet me zero pikë.	Vlerësimi me 5 pikë
	Totali	30 pikë

Shtojcë nr. 4**Formulari i aplikimit për trajnues në programin “Pas shkolle”****NID*:****Emri*:****Mbiemri*:****Nr. Cel*:****Email*:****DRAP*:****ZVAP*:****Shkollat ku dëshiron të punësohet*:****Komponenti/Fusha ku dëshiron të aplikojë*:**

Komponenti/Fusha	Zgjedhja
BDSH	☐
KAZ	☐
TEATËR	☐
MUZIKË	☐
KËRCIM	☐
ART PAMOR	☐
ZEJE	☐

Shënim: Vendors shenjë ☒ në kutinë përkatëse të fushës ku dëshiron të aplikosh.